FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 158

Tiranë – E Martë, 14 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 121/2014 datë 18.9.2014	Për azilin në Republikën e Shqipërisë ……..	8113
Vendim i Kuvendit nr. 74/2014, datë 9.10.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	8132
Vendim i Kuvendit nr. 75/2014, datë 9.10.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	8132
Dekret nr. 8731 datë 6.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare …….....	8132
Dekret nr. 8732 datë 7.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare …….....	8133
Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 6, datë 6.10.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012 "Dokumentet e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre" ……...	8133
Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7, datë 7.10.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 2, datë 11.2.2010 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore", të ndryshuar …….....	8133
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4111/3, datë 7.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan, loti III, rrëshqitjet"…….....	8134
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4244/3, datë 7.10.2014	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga objekti "Rehabilitimi i Stacionit të Pompimit Trush".....	8137
Kërkesë e Ministrisë së Kulturës nr. 4451, datë 1.10.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza""……..	8139

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 17, datë 14.7.2014	Për rinovim licence Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime, Bashkia Pukë	8139
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 18, datë 14.7.2014	Për rinovim licence sh. a. Ujësjellës Kanalizime Durrës…….....	8140
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 19, datë 14.7.2014	Për rinovim licence "Elber" sh.p.k…….....	8140
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Agron Mëhalla….....	8140

LIGJ
Nr. 121/2014

PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim parashikimin e kushteve e të procedurave për dhënien dhe heqjen e azilit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi:

a) i parimeve dhe kushteve themelore për njohjen dhe garantimin e së drejtës së personave të huaj apo pa shtetësi për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare;

b) i autoriteteve përgjegjëse dhe i kompetencave të tyre në trajtimin e të huajve dhe personave pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare;

c) i mënyrave të regjistrimit dhe i dokumenteve, me të cilat pajisen personat që kanë kërkuar azil dhe ata që kanë përfituar një nga format e mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;

ç) i statusit të refugjatit dhe statusit të mbrojtjes plotësuese;

d) i të drejtave që burojnë nga mbrojtja ndërkombëtare;

dh) i së drejtës së ankimit administrativ dhe gjyqësor.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Azil" është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve.

b) "Kërkesë për azil" është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdolloj mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

c) "Aplikim për azil" është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me:*

Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, "Standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet shteteve anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave", numri CELEX 32001L005, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 212, datë 7.8.2001, faqe 12–23.

Direktivën e Këshillit 2003/9/KE, datë 27 janar 2003 "Për përcaktimin e standardeve minimale për pritjen e azilkërkuesve", numri CELEX 32003L0009, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 31, datë 6.2.2003, faqe 18–25.

Direktivën e Këshillit 2003/86/EC, datë 22 shtator 2003, "Mbi të drejtën e bashkimit familjar", numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, faqe 12–18.

Direktivën e Këshillit 2005/85/KE, datë 1 dhjetor 2005, "Për përcaktimin e standardeve minimale të procedurave në shtetet anëtare për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit", numri CELEX 32005L0085, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L nr. 326, datë 13.12.2005, faqe 13-34.

Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2011/95/BE, datë 13 dhjetor 2011 "Standardet për cilësimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët dhe për personat e pranueshëm për mbrojtje plotësuese dhe përmbajtja e mbrojtjes së dhënë", numri CELEX 32011L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L nr. 337,datë 20.12.2011, faqe 9–26.

si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

ç) "Azilkërkues" është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

d) "Refugjat" është i huaji apo personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose vendit të zakonshëm të banimit dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.

dh) "Status i refugjatit" është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.

e) "I mitur i pashoqëruar" është i huaji apo personi pa shtetësi nën 18 vjeç, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për të, sipas ligjit ose sipas traditës, ose është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për sa kohë ai nuk është efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë.

ë) "Mbrojtje e përkohshme" është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa krijuar efekte të pafavorshme në funksionimin e tij efektiv, në interes të këtyre personave.

f) "Fluks masiv" është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e një mase të madhe të personave të shpërngulur, të cilët vijnë nga një shtet apo zonë gjeografike e caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.

g) "Heqje e statusit të refugjatit" është vendimi i marrë nga autoriteti përgjegjës për revokimin e statusit të refugjatit.

gj) "Person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese" është i huaji ose personi pa shtetësi, i cili nuk konsiderohet si refugjat, por për të cilin janë shfaqur arsye thelbësore për të besuar se, nëse ai kthehet në vendin e tij të origjinës apo, në rastin e personit pa shtetësi, në vendin e tij të banimit të mëparshëm të zakonshëm, do të përballet me rrezik real të cenimit serioz dhe është në pamundësi apo, për shkak të rrezikut të tillë, nuk dëshiron të shfrytëzojë mbrojtjen e atij vendi.

h) "Status i mbrojtjes plotësuese" është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.

i) "Bashkim familjar" është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë i anëtarëve të familjes së një refugjati, të cilët nuk janë shtetas shqiptarë, me synim ruajtjen e unitetit të familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia krijohet para apo pas hyrjes së refugjatit në Republikën e Shqipërisë.

j) "Anëtarët e familjes" janë të afërmit e azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese, sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin për të huajt.

k) "I huaj" është personi, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për të huajt.

l) "Kujdestar" është personi, të cilit i njihet kjo cilësi sipas Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë ose që është caktuar tashmë, si i tillë, sipas ligjit apo traditës së vendit nga vjen i huaji që kërkon azil.

ll) "Qendër pritëse për azilkërkuesit" është çdo vend i caktuar për strehim kolektiv të azilkërkuesve.

m) "Moskthim" është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer të huajin ose personin pa shtetësi në çfarëdolloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve politike të tij.

n) "Shtet apo vend i origjinës" është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.

nj) "UNHCR" është Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

o) "Konventa e Gjenevës" është Konventa për Statusin e Refugjatit, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967, të ratifikuar.

p) "Ministri përgjegjës" është ministri që mbulon strukturën përgjegjëse për azilin dhe refugjatët.

Neni 4
E drejta për azil

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për azil e të huajit apo personit pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, si pasojë e këtyre ngjarjeve, për arsye të kësaj frike.

Neni 5
Përjashtimi nga e drejta për azil

1. E drejta për azil nuk i garantohet të huajit kur ka të dhëna për:

a) kryerjen e një krimi kundër paqes, krimi lufte apo kundër njerëzimit, kryerjen e një akti terrorist, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare;

b) kërcënimin e rendit publik dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë jopolitik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, para hyrjes si azilkërkues në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) fajësinë për veprime që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

2. E drejta për azil nuk i jepet një të huaji të marrë nën mbrojtje apo asistencë nga organet e OKB-së, me përjashtim të rasteve kur mbrojtja i garantohet nga Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët e Kombeve të Bashkuara (UNHCR).

3. Nëse mbrojtja ose asistenca, referuar pikës 2, të këtij neni, ka pushuar për ndonjë arsye, i huaji përfiton azil nëse plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

4. Azili nuk i jepet një të huaji që ka të drejta dhe detyrime të barabarta me shtetasit e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur të drejtat dhe detyrimet lidhen specifikisht me shtetësinë shqiptare.

Neni 6
Parimi i moskthimit

1. Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton detyrimin e autoriteteve për të mos kthyer a prapësuar, ekstraduar apo larguar jashtë territorit të saj personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes për këto raste:

a) në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;

b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Europiane apo në traktatet/konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;

c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;

ç) në shtetin e tyre të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) në një shtet të tretë, i cili mund ta kthejë ose ta dërgojë personin në një nga shtetet, sipas përcaktimeve të shkronjave "a" , "b" dhe "c", të këtij neni.

2. I huaji, të cilit aplikimi për azil i është refuzuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nuk dëbohet apo nuk nxirret jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përpara ushtrimit apo dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

3. Për rastet përjashtimore, azilkërkuesi mund të kthehet kur:

a) ka arsye të bazuara e të arsyetuara në vendim për ta konsideruar si një rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

b) është dënuar me vendim të formës së prerë për një krim që dënohet minimalisht me 7 vjet burgim, i cili përbën një rrezik për rendin dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7
Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët.

2. Autoriteti kompetent në kufi për trajtimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin.

3. Komisioneri Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është drejtuesi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

4. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës për ankimet kundër vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

5. Autoriteti përgjegjës për pajisjen me leje pune dhe trajtimin e marrëdhënieve të punës së refugjatëve e të personave në mbrojtje është struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës.

Neni 8
Kushtet për kërkesën dhe aplikimin për azil

1. I huaji që kërkon azil në Republikën e Shqipërisë duhet:

a) të paraqesë kërkesën pranë autoriteteve policore kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të paraqesë kërkesën për azil;

b) të plotësojë aplikimin për azil pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe të plotësojë aplikimin për azil.

2. Në rastet kur kërkohet azil, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, autoritetet kompetente në kufi duhet të bëjnë njoftimin e rastit dhe dërgimin e menjëhershëm të tij pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në mënyrë që të regjistrohet dhe të plotësojë aplikimin për azil, në përputhje me formularët e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës.

3. Procedura dhe rregullat e dërgimit të rastit nga autoriteti kompetent kufitar tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës.

Neni 9
Vend i tretë i sigurt

Zbatimi i konceptit të vendit të tretë të sigurt realizohet vetëm kur autoritetet kompetente kanë krijuar bindjen e arsyeshme se personi që kërkon azil do të trajtohet në vendin e tretë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) moskërcënimi i jetës dhe lirisë për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë social ose mendimit politik;

b) respektimi i parimit të moskthimit, në përputhje me Konventën e Gjenevës dhe të drejtën ndërkombëtare;

c) ndalimi i dëbimit, nëse shkelet e drejta për liri nga tortura e trajtimi çnjerëzor ose poshtërues dhe e drejta për të mos qenë subjekt i zhdukjes me forcë, siç përcaktohet nga e drejta ndërkombëtare;

ç) ekziston mundësia për të kërkuar statusin e refugjatit dhe, nëse është refugjat, duhet të marrë mbrojtje në përputhje me Konventën e Gjenevës.

Neni 10
Refuzimi i azilit, për shkak të ardhjes nga një vend i tretë i sigurt

1. Azili i refuzohet të huajit që vjen nga një vend i tretë i sigurt, palë e Konventës së Gjenevës apo protokollit të saj të vitit 1967, kur nga ky vend azilkërkuesi nuk mund të parashtrojë frikë të bazuar persekutimi për të paktën njërën prej arsyeve të parashikuara në Konventën e Gjenevës, si edhe as ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut apo rrezikut të dëbimit, në kuptimin e dispozitave të këtij ligji, apo edhe kur ai mund të kthehet ligjërisht në këtë vend, ku aplikimi i tij për status refugjati do të shqyrtohet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Lista e vendeve të treta të sigurta miratohet dhe përditësohet për këtë qëllim me vendim të Këshillit të Ministrave, duke u konsultuar edhe me listën e hartuar nga Bashkimi Europian ose, në mungesë të saj, me njërën prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Neni 11
Ndalimi i azilkërkuesve

1. Azilkërkuesit, që hyjnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të ndiqen penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit, me kusht që ata të paraqiten

përpara autoriteteve përkatëse brenda 10 ditëve nga dita e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Azilkërkuesit, të cilët paraqiten brenda afatit, mund të ndalohen vetëm për arsyet e mëposhtme:

a) për verifikimin e identitetit të tyre;

b) kur nuk kanë dokumente identifikimi;

c) kur janë kapur me dokumente të falsifikuara, me përjashtim të rastit kur ata i kanë përdorur këto dokumente për t'u larguar nga vendi për shkak të frikës dhe e kanë deklaruar këtë fakt vetë në kufi ose kur aplikojnë për azil;

ç) ndaj tyre është lëshuar një mandat arresti ndërkombëtar;

d) për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe të rendit publik.

3. Masat shtrënguese ndaj një azilkërkuesi merren në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin penal dhe procedural në fuqi. Në çdo rast azilkërkuesit i garantohet e drejta e kontaktit me UNHCR-në.

4. Në rast ndalimi apo arrestimi, azilkërkuesi mbahet në ambiente të veçuara nga personat e tjerë, përveç kur këto masa shtrënguese merren në bazë të shkronjës "c", të pikës 2, të këtij neni.

5. Në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, në rastin e azilkërkuesve të mitur të pashoqëruar, nën moshën 18 vjeç, ata nuk mund të vendosen në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

Neni 12
Paraqitja e aplikimit për azil

1. Azilkërkuesi duhet të plotësojë aplikimin për azil sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Azikërkuesi informohet jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga data e paraqitjes së aplikimit për azil, në lidhje me procedurën për dhënien e azilit, mbi të drejtat dhe detyrimet që ai ka gjatë procedurës, mbi mundësinë për të kontaktuar dhe për të pasur asistencë ligjore nga përfaqësuesit e UNHCR-së dhe përfaqësuesit e organizatave të tjera për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve, si dhe kujdesin shëndetësor.

Neni 13
Bashkëpunimi me Zyrën e UNHCR-së

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunon me Zyrën e UNHCR-së për çështjet e azilit dhe të refugjatëve.

2. Shkëmbimi i informacionit si dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit përgjegjës për azilin e refugjatët dhe UNCHR-së, përcaktohen në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet ministrit përgjegjëse për azilin dhe refugjatët dhe UNCHR-së.

Neni 14
E drejta e qëndrimit të azilkërkuesit gjatë aplikimit

1. Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në përfundimin e procedurës së filluar prej tij.

2. Anëtarët e familjes së azilkërkuesit, të cilët kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë së bashku me azilkërkuesin, kanë të drejtë të qëndrojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 15
E drejta për përkthyes

1. Nëse azilkërkuesi nuk kupton gjuhën, në të cilën zhvillohet procedura, atij i sigurohet një përkthyes në gjuhën që ai kupton. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët ka detyrimin të vendosë në dispozicion të azilkërkuesit kopje të këtij ligji dhe të gjitha akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe kopje të dokumenteve, si leje qëndrimi, në një gjuhë zyrtare të OKB-së, e cila mund të jetë e kuptueshme për ata.

2. Të drejtën për përkthyes, sipas pikës 1, të këtij neni, e gëzojnë edhe të huajt në mbrojtje të përkohshme dhe mbrojtje plotësuese.

Neni 16
I mituri i pashoqëruar

1. Për azilkërkuesin e mitur të pashoqëruar duhet të emërohet një kujdestar, sipas rregullave dhe procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Procedura për caktimin e kujdestarit ndiqet me përparësi dhe asistohet nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Një e drejtë e tillë i njihet edhe të miturit të pashoqëruar në mbrojtje të përkohshme ose plotësuese.

2. Aplikimi për azil i një të mituri të pashoqëruar duhet të trajtohet menjëherë. Për aq sa mundet, fëmijët e në familjeje, duhet të mbahen bashkë.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët duhet të kryejë procedurën e aplikimit për azil, duke marrë parasysh shkallën e pjekurisë fizike e mendore të të miturit dhe, kur është e nevojshme, i mituri të dëgjohet në prani të një psikologu.

Neni 17

Interesi më i lartë i fëmijës

Në zbatimin e këtij ligji, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese, në përputhje me Konventën e OKB-së, "Mbi të drejtat e fëmijës".

Neni 18

Detyrimet e përgjithshme të azilkërkuesve dhe refugjatëve

1. Azilkërkuesi dhe refugjati kanë detyrimin të zbatojnë Kushtetutën, rendin juridik dhe kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë.

2. Azilkërkuesi dhe refugjati janë të detyruar të bashkëpunojnë me organet shtetërore kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe të veprojnë në përputhje me masat dhe udhëzimet e tyre.

Neni 19

Kufizimet e veprimtarisë politike

Azilkërkuesit dhe refugjatët nuk mund të krijojnë, të bashkohen apo të mbështetin e të veprojnë në grupime politike apo organizata të tjera, që cenojnë rendin dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Mbledhja e të dhënave

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, për qëllime të këtij ligji, mbledh dhe përpunon të dhënat personale të azilkërkuesve/refugjatëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të policisë dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave.

3. Rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatin miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

KREU II

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR TRAJTIMIN E AZILKËRKUESVE/REFUGJATËVE DHE PERSONAVE NË MBROJTJE

Neni 21

Kompetencat e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët

1. Autoriteti i vetëm për dhënien, heqjen dhe përjashtimin nga e drejta për azil dhe mbrojtje ndërkombëtare është struktura pranë ministrisë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët. Ajo është përgjegjëse për trajtimin e aplikimeve, procedimin, shqyrtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunon me Shërbimin Informativ të Shtetit për çështjet e azilit.

Neni 22

Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët

1. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës për ankimet e bëra kundër vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

2. Krijimi, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

E drejta e komunikimit me UNHCR-në

1. Azilkërkuesit, refugjatët dhe personat në mbrojtje kanë të drejtë të kontaktojnë me Zyrën e Komisionerit të Lartë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara (UNHCR). Përfaqësuesit e UNHCR-së kanë të drejtë të takohen me çdo azilkërkues, refugjat apo person në mbrojtje, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me kërkesë të UNHCR-së, dërgon pranë saj informacionin e nevojshëm për azilkërkuesit e regjistruar dhe, në mënyrë të veçantë, i mundëson UNHCR-së, në bazë të kërkesës, shqyrtimin e dosjeve individuale të azilkërkuesve dhe refugjatëve. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i dërgon UNHCR-së listën e aplikimeve që shqyrtohen nga ky autoritet e të ankimeve që janë paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që kërkohet për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendase me UNHCR-në, në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund t'i kërkojë UNHCR-së mendime apo rekomandime me karakter të përgjithshëm, si dhe rekomandime për raste të veçanta apo gjatë flukseve masive.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i njeh UNHCR-së, kur ajo e kërkon, të drejtën për të marrë pjesë me statusin e vëzhguesit në mbledhjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese apo mbrojtjes së përkohshme.

KREU III
DOKUMENTET DHE REGJISTRIMI I AZILKËRKUESVE DHE REFUGJATËVE

Neni 24
Detyrimi për pajisjen me dokumente

1. Azilkërkuesi pajiset me dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e dorëzimit të aplikimit për azil;

b) leje të përkohshme qëndrimi, të lëshuar nga autoritetet për të huajt, sipas procedurave të parashikuara nga ligji për të huajt, e cila shërben edhe si dokument identifikimi;

c) leje pune.

2. Refugjati pajiset me dokumentet e mëposhtme:

a) letërnjoftim elektronik për refugjatin;

b) dokument udhëtimi për refugjatin;

c) leje të përhershme qëndrimi.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i kërkon ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme të pajisë me vizë refugjatin, pas paraqitjes së kërkesës së tij, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25
Mbajtja e përkohshme e dokumenteve të huaja

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të mbajë një dokument të huaj të udhëtimit ose dokument identifikimi të azilkërkuesit dhe refugjatit nëse kjo kërkohet për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

2. Dokumentet e sipërpërmendura mund të bllokohen:

a) deri në revokimin e statusit të refugjatit;

b) për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për mbajtjen e tyre.

3. Procedurat e bllokimit të dokumenteve për të huajin, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt, zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi në këtë fushë. Në rast bllokimi të dokumenteve, lëshohet një certifikatë e përkohshme derisa të zhbllokohet mbajtja e përkohshme e dokumenteve të huaja.

4. Personi i interesuar ka të drejtën e ankimit administrativ dhe atij gjyqësor në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 26
Vërtetimi i dorëzimit të aplikimit për azil

1. Vërtetimi i dorëzimit të aplikimit për azil i azilkërkuesit shërben si dëshmi e fillimit të procedurave për azil dhe dhënies së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, deri në përfundimin e procedurës. Ky vërtetim lëshohet jo më vonë se 3 ditë nga data e dorëzimit të aplikimit.

2. Vërtetimi i dorëzimit të aplikimit për azil për azilkërkuesit duhet të lëshohet edhe për anëtarët e familjes së tij.

3. Formati i vërtetimit të dorëzimit të aplikimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës.

Neni 27
Dokumenti i udhëtimit dhe letërnjoftimi elektronik për refugjatin

1. Refugjatit, me kërkesën e tij, i lëshohet letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi.

2. Për refugjatin e mitur, kërkesa për pajisje me dokument udhëtimi kryhet me kërkesë dhe në prezencë të të paktën njërit prej prindërve, të kujdestarit ose të përfaqësuesit me prokurë të posaçme.

3. Refugjati i mitur nën 16 vjeç pajiset vetëm me dokument udhëtimi, me vlefshmëri 5 vjet.

4. Refugjati mbi 16 vjeç pajiset me letërnjoftim elektronik dhe me dokument udhëtimi, me vlefshmëri 10 vjet, për secilin dokument.

5. Kriteret dhe procedura për pajisjen me letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi për këtë kategori personash përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

Neni 28
Kthimi i dokumenteve

1. Dokumentet e mbajtura sipas nenit 25 i kthehen personit pas përfundimit të procedurave të azilit ose pas marrjes së statusit të refugjatit.

2. Në rast humbjeje apo dëmtimi të dokumenteve të lëshuara, zbatohen dispozitat e ligjit për të huajt.

Neni 29
Regjistrimi

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët regjistron në një regjistër të posaçëm të dhënat personale dhe elementet e nevojshme të dokumenteve të përcaktuara në këtë ligj për azilkërkuesit dhe refugjatët dhe për ata që janë në mbrojtje. Kriteret, procedurat për mbajtjen e këtij regjistri dhe formati i tij miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës.

2. Refugjatët dhe të huajt në mbrojtje plotësuese regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

3. Të dhënat personale të administruara në këta regjistra përpunohen në përputhje me parimet e mbrojtjes të të dhënave personale.

KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AZILKËRKUESVE

Neni 30
Të drejtat e azilkërkuesve

1. Azilkërkuesi trajtohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Azilkërkuesit i garantohet:

a) e drejta e moskthimit, sipas nenit 6, të këtij ligji;

b) e drejta e strehimit, e ushqimit, e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera publike për nevoja ngushtësisht vetjake, të ofruara në qendrën kombëtare pritëse për azilkërkuesit.

3. Azilkërkuesit e mitur akomodohen së bashku me prindërit e tyre ose pjesëtarët madhorë të familjes, përgjegjës për ata.

Neni 31
Detyrimet e azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë

1. Azilkërkuesi në Republikën e Shqipërisë ndalohet të angazhohet në veprimtari që cenojnë rendin publik dhe sigurinë kombëtare dhe mund të ndikojnë në marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera.

2. Azilkërkuesi në Republikën e Shqipërisë nuk duhet të veprojë kundër parimeve dhe qëllimeve, që burojnë nga traktatet dhe konventat e OKB-së, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe e drejta ndërkombëtare publike.

3. Azilkërkuesi duhet të japë çdo informacion, për të cilin mendohet se ai ka dijeni, kur i kërkohet nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe që shërben për marrjen e një vendimi të bazuar e të drejtë për aplikimin e tij për azil.

4. Azilkërkuesi duhet të jetë në dispozicion të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të aplikimit për azil.

Neni 32
Qendra pritëse për azilkërkuesit

1. Azilkërkuesi, pas paraqitjes së kërkesës për azil, akomodohet në qendrën pritëse për azilkërkuesit. Në këtë qendër do të vazhdojë të akomodohet edhe personi, të cilit i është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre.

2. Organizimi dhe funksionimi i qendrës pritëse rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Qendra duhet të sigurojë kushtet minimale të jetesës, përfshirë:

a) akomodimin;

b) ushqimin;

c) sigurimin shëndetësor;

ç) kushtet minimale të higjienës.

4. Në bashkëpunim me subjekte të tjera, private apo shtetërore, vendase apo të huaja, në përputhje me të drejtat e azilkërkuesve e të refugjatëve,

zhvillohen programe pedagogjike e edukuese, si dhe këshillim ligjor falas.

5. Azilkërkuesi mund të përfitojë edhe ndihma humanitare.

6. Azilkërkuesit, të cilët disponojnë mjete financiare ose që e kanë të garantuar jetesën, nuk përfitojnë ndihma financiare.

Neni 33
Shërbimet e kujdesit shëndetësor

1. Azilkërkuesit përfitojnë shërbime të kujdesit shëndetësor, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për kujdesin shëndetësor.

2. Azilkërkuesit e mitur përfitojnë shërbim shëndetësor të plotë, si për shtetasit e mitur shqiptarë.

KREU V
PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR AZIL

Neni 34
Aplikimi për azil dhe shqyrtimi

1. Aplikimi për azil plotësohet me shkrim. Nëse personi nuk kupton gjuhën, me të cilën zhvillohet procedura, atij i sigurohet përkthyes në gjuhën që ai kupton. Aplikimi, përveç identitetit, duhet të përmbajë dhe shkaqet, për të cilat azilkërkuesi kërkon mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Azilkërkuesi është i detyruar të paraqesë të gjitha të dhënat personale dhe të plotësojë të gjithë formularët përkatës, të vënë në dispozicion nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

3. Në kohën e plotësimit të aplikimit për azil, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon azilkërkuesin për procedurat e marrjes së statusit të refugjatit dhe i mundëson atij kontaktin me një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve, për shërbime ligjore falas.

4. Për periudhën deri në dhënien e vendimit përfundimtar për aplikimin për azil, azilkërkuesi lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Personi, që ka aplikuar për azil, nuk mund të kërkojë leje qëndrimi me motiv tjetër, në bazë të ligjit për të huajt.

6. Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në qendrën pritëse gjatë kohëzgjatjes së procedurës për marrjen e statusit të refugjatit. Në qoftë se azilkërkuesi ka mundësi të qëndrojë jashtë qendrës pritëse dhe përballon kushtet minimale të jetesës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vendos largimin e azilkërkuesit brenda 30 ditëve.

Neni 35
Kushtet dhe procedura administrative e dëgjimit dhe shqyrtimit të aplikimit

1. Azilkërkuesi duhet të dëgjohet për aplikimin e tij për azil nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, i cili duhet të marrë në konsideratë gjendjen dhe rrethanat, në të cilat aplikuesi ndodhet. Azilkërkuesi njoftohet me shkrim për caktimin e datës së dëgjimit, e cila nuk mund të jetë më vonë se 21 ditë nga data e paraqitjes së aplikimit të plotë pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

2. Azilkërkuesi mund të pyetet dhe të ripyetet për faktet e ngjarjet e deklaruara gjatë dëgjimit, kur ka paqartësi për ato fakte apo për informacionet e mbledhura nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda një periudhe jo më vonë se 20 ditë nga data e seancës së dëgjimit. Për datën e ridëgjimit njoftohet me shkrim i interesuari.

3. Azilkërkuesi, në çdo fazë të procedurës, shoqërohet, këshillohet apo përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve.

4. Azilkërkuesit e seksit femër, nëse është e mundur, dëgjohen dhe pyeten nga punonjëse femra të personelit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët. I mituri azilkërkues, i pashoqëruar, dëgjohet dhe pyetet në prani edhe të një psikologu apo të një të rrituri, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij.

5. Azilkërkuesi duhet të shpjegojë faktet, ku mbështeten arsyet dhe motivet për persekutimin e tij apo për shkeljen e të drejtave të njeriut, dhe të japë të dhënat e nevojshme, ku përfshihen informacioni për vendbanimin e përhershëm, për itinerarin, ndalesat në vendet e tjera dhe kërkesat e mundshme për azil në vende të tjera, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për sqarimin e rrethanave të rastit.

6. Në seancën e dëgjimit mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues i UNHCR-së.

Neni 36
Konfidencialiteti gjatë procedurës së dëgjimit

1. Seanca e dëgjimit të azilkërkuesit nuk është publike dhe atij i garantohet zhvillimi konfidencial i kësaj seance.

2. Punonjësit e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mospërhapjes së informacionit të marrë, për shkak të detyrës gjatë mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale për trajtimin e refugjatëve apo personave në mbrojtje, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre edhe pas përfundimit të funksioneve, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

3. Për përmbushjen e këtij detyrimi, personat pjesëmarrës në seancën e dëgjimit nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti, sipas së cilës duhet të ruajnë konfidencialitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi edhe pas përfundimit të detyrës së tyre.

Neni 37
Zhvillimi i procedurave nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët fillon procedurat administrative dhe regjistron të gjitha të dhënat e rëndësishme të ofruara nga azilkërkuesi. Pasi aplikimi për azil të jetë plotësuar me të gjitha të dhënat dhe formularët e nevojshëm, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i lëshon azilkërkuesit një vërtetim, me të cilin vërtetohen identiteti i tij dhe marrja e aplikimit për azil, duke e garantuar për moskthimin e tij, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët drejton dëgjimin, verifikon faktet e dhëna, shqyrton dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm para marrjes së vendimit. Në dosje vendoset edhe rekomandimi i dhënë nga UNHCR-ja për aplikimin për azil.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr vendim në bazë të deklarimeve përkatëse të aplikuesit, të marra sipas parashikimeve të këtij ligji. Në marrjen e vendimit përkatës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mbështetet në parimin e besueshmërisë dhe në prezumimin që azilkërkuesi ka të drejtë, si dhe mban parasysh rekomandimet e paraqitura nga UNHCR-ja.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dëgjimit të azilkërkuesit dhe u dërgon, pa vonesë, azilkërkuesit dhe UNHCR-së një kopje të vendimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit. Vendimi i këtij autoriteti merret në një mbledhje të posaçme me shumicë votash e në mënyrë sa më konsensuale dhe procedura e marrjes së vendimit u nënshtrohet, për aq sa është e mundur, parimeve dhe legjislacionit në fuqi për marrjen e vendimeve nga organet kolegjiale. Ai duhet të përpilohet me shkrim dhe të jetë i arsyetuar. Punonjësit e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, të cilët janë në pakicë, mund ta shprehin me shkrim mendimin e tyre kundër, i cili duhet t'i bashkëlidhet vendimit përfundimtar.

5. Në rast se aplikimi për azil pranohet, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon azilkërkuesin për kushtet e azilit dhe se statusi i refugjatit mund të revokohet vetëm në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

6. Në rast se aplikimi për azil nuk pranohet, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon me shkrim azilkërkuesin për vendimin me karakter individual dhe të arsyetuar, ku parashikohen e drejta e subjektit për ankim, organi ku mund të paraqitet ky ankim dhe afati, brenda të cilit ai mund ta ushtrojë këtë të drejtë.

Neni 38
Kufizimi i lirisë së lëvizjes

1. Liria e lëvizjes së azilkërkuesit mund të kufizohet për:

a) shkaqet e përmendura në pikën 2, të nenit 11, të këtij ligji;

b) parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive;

c) shkeljen e ligjit dhe akteve të tjera nënligjore, si dhe masat e marra me qëllim ruajtjen e rendit publik.

2. Kufizimi i lirisë mund të bëhet në rastet e mëposhtme:

a) ndalimi për të lëvizur jashtë qendrës pritëse për azilkërkuesit;

b) ndalimi për të lëvizur jashtë zonës së caktuar; ose

c) detyrimi për të lënë një adresë të caktuar.

3. Lëvizja kufizohet për një periudhë deri në 3 muaj dhe për rrethana të justifikuara mund të zgjatet deri në 1 muaj.

4. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 3, të këtij neni, kufizimi i lirisë së lëvizjes, për arsyet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, është i vlefshëm për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për kufizim.

5. Kufizimi i lirisë së lëvizjes bëhet nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët me vendim të arsyetuar, formati i të cilit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës.

6. Kundër vendimit të kufizimit të lirisë së lëvizjes bëhet ankim brenda 15 ditëve pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 39
Mospranimi i aplikimit për azil

1. Aplikimi për azil nuk pranohet nëse:

a) vërtetohet se azilkërkuesi vjen nga një vend i tretë i sigurt, në kuptim të nenit 9 të këtij ligji;

b) aplikimi për azil në Republikën e Shqipërisë është refuzuar ose nuk është pranuar apo procedura është pezulluar dhe nuk janë paraqitur prova që vërtetojnë rrethanat, mbi të cilat është bazuar aplikimi i mëparshëm apo prova të reja.

2. Kundër vendimit për mospranimin e aplikimit për azil, azilkërkuesi mund të bëjë ankim brenda 15 ditëve pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

3. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët merr vendim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes se ankesës.

Neni 40
Refuzimi i aplikimit për azil

1. Aplikimi për azil refuzohet nëse:

a) azilkërkuesi nuk i përmbush kushtet për njohjen e së drejtës së azilit, sipas nenit 4 të këtij ligji;

b) ekziston ndonjë nga arsyet e parashikuara në nenin 5 të këtij ligji;

c) aplikimi është i pabazuar në themel;

ç) azilkërkuesi ka edhe shtetësinë e një vendi të tretë, mbrojtjen e të cilit nuk e ka kërkuar.

2. Kundër vendimit për refuzimin e aplikimit për azil, si të pabazuar, azilkërkuesi mund të bëjë ankim, brenda 15 ditëve, pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

3. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët vendos për ankesën e bërë në bazë të pikës 2, të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.

Neni 41
Pretendimet abuzive dhe të pabazuara

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vlerësojë një aplikim si "abuziv", kur është vërtetuar, në mënyrë të pakundërshtueshme, se pretendimi i bërë nga azilkërkuesi nuk është i vërtetë dhe është bërë me qëllim për të mashtruar autoritetet.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vlerësojë një aplikim si "dukshëm të pabazuar", kur pretendimi i bërë nga azilkërkuesi nuk ka lidhje, në asnjë mënyrë, me kriteret për dhënien e azilit, të parashikuara sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Në rastet kur autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vlerëson se një aplikim për azil është "abuziv" apo "dukshëm i pabazuar", ai merr vendim të ndërmjetëm, me shkrim dhe të arsyetuar, i cili përfshihet në dosjen e azilkërkuesit. Kundër këtij vendimi azilkërkuesi ka të drejtë të bëjë ankim, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Në këto raste zbatohet procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të aplikimit. Nëse në fazën e parë të procedurës së përshpejtuar, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk shprehet me vendim brenda 10 ditëve, aplikimi pranohet vetvetiu sipas procedurës normale të dhënies së statusit të refugjatit. Azilkërkuesi ka të drejtën e ankimit brenda 15 ditëve, duke filluar nga data kur ai merr dijeni për vendimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Neni 42
Mashtrimi gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit për azil

Mashtrim gjatë procedurës konsiderohet kur azilkërkuesi vepron sipas rrethanave të mëposhtme:

a) bazon kërkesën e tij në identitet të rremë ose dokumente të falsifikuara, me përjashtim të rastit kur ata i kanë përdorur këto dokumente për t'u larguar nga vendi, për shkak të frikës dhe e kanë deklaruar këtë fakt;

b) bazon aplikimin e tij mbi arsye të rreme;

c) qëllimisht shkatërron pasaportën, biletën e udhëtimit ose dokument tjetër, i cili mund të shërbejë për dhënien e vendimit për aplikimin për azil;

ç) fsheh faktin që ai kishte paraqitur më parë një aplikim për azil në një vend tjetër dhe veçanërisht ka përdorur identitet të rremë;

d) bën aplikimin, me qëllim shtyrjen e urdhrit të detyruar të largimit.

Neni 43

Pezullimi dhe pushimi i procedurës së shqyrtimit të aplikimit për azil

1. Procedura për dhënien e azilit pezullohet kur azilkërkuesi:

a) tërheq aplikimin për azil;

b) nuk paraqitet në dëgjimin e çështjes, pa arsye të justifikuara;

c) nuk informon në kohë autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët në lidhje me ndryshimin e adresës së tij, pa një arsye të justifikuar, ose, në disa mënyra të tjera, pengon njoftimin;

ç) nuk merr pjesë në verifikimin e identitetit të tij;

d) shmang dhënien e informacionit në lidhje me faktet dhe rrethanat ose për provat përkatëse në posedim të tij për përcaktimin e ligjshmërisë së aplikimit;

dh) largohet nga Republika e Shqipërisë gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit për azil.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, pas pezullimit, sipas shkronjave "a" dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, merr vendim për pushimin e shqyrtimit të aplikimit për azil.

3. Procedura dhe afati për marrjen e vendimit për pushimin e shqyrtimit të aplikimit për azil përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

Neni 44

Pjesëmarrja e personave të tjerë në procedurën e shqyrtimit të aplikimit për azil

1. Procedura për dhënien e azilit është e mbyllur për publikun.

2. Personat, të cilët marrin pjesë në procedurën e shqyrtimit të aplikimit për azil, janë:

a) përfaqësuesi ligjor ose kujdestari i të miturit të pashoqëruar;

b) kujdestari i një të rrituri me aftësi të kufizuara.

3. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij neni, nëse azilkërkuesi nuk kundërshton, një përfaqësues i UNHCR-së ose i organizatave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve mund të marrë pjesë gjatë procedurës për shqyrtimin e aplikimit për azil.

Neni 45

Revokimi, mbarimi dhe ose refuzimi për të ripërtërirë statusin e refugjatit

Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të revokojë, të mbarojë apo të refuzojë për të ripërtërirë statusin e refugjatit nëse:

a) refugjati pohon vullnetarisht në çfardolloj forme se gëzon mbrojtjen e vendit të origjinës ose të ndonjë vendi tjetër të vendqëndrimit të tij të mëparshëm;

b) i huaji fiton shtetësinë dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë së fituar;

c) nuk ekzistojnë rrethanat, për të cilat i është dhënë statusi i refugjatit;

ç) provohet se i huaji, që ka përfituar azil, ka paraqitur fakte dhe rrethana të pavërteta për marrjen e statusit të refugjatit, të cilat kanë qenë vendimtare në marrjen e statusit;

d) kur i huaji ka edhe shtetësi tjetër;

dh) kur vërtetohet një nga rrethanat e nenit 5 të këtij ligji;

e) ai vepron në kundërshtim me përcaktimin e nenit 18 të këtij ligji;

ë) ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë duke lëshuar një deklaratë të shkruar ose kur largohet nga Republika e Shqipërisë për më shumë se 90 ditë, pa njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët;

f) atij i është njoftuar masa e largimit ose dëbimit.

Neni 46

Largimi nga territori

1. Azilkërkuesit, të cilit i është refuzuar ose nuk i është pranuar aplikimi për azil apo i është revokuar vendimi i statusit të refugjatit, është subjekt i largimit nga territori, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt.

2. Familjarët, të cilët kanë përfituar bashkim familjar me të huajin, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, janë gjithashtu në të njëjtën kohë subjekt largimi.

Neni 47
E drejta e ankimit

1. Të gjitha vendimet për dhënien, revokimin, mbarimin e heqjen e statusit të refugjatit, statusit të mbrojtjes plotësuese, si dhe çdo akt tjetër vendimmarrës i autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të ankimohen pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

2. Vendimi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët mund të ankimohet në gjykatën kompetente për çështjet administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI
TË DREJTAT E REFUGJATËVE

Neni 48
Të drejtat e refugjatëve

1. Refugjati në Republikën e Shqipërisë gëzon status ligjor, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, me seksionin e Aktit Final të Konferencës së të Plotfuqishmëve, me konventën e OKB-së së vitit 1951, "Për statusin e refugjatëve" dhe me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, si dhe të gjitha të drejtat që legjislacioni shqiptar u njeh të huajve.

2. Refugjati pajiset me leje qëndrimi të përhershme dhe me leje pune të posaçme.

3. Refugjati pajiset me letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi. Ky dokument, për aq kohë sa është i vlefshëm, mund të përdoret për të udhëtuar në të gjitha shtetet, me përjashtim të shtetit të origjinës, dhe për t'u rikthyer në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur arsye të forta të sigurisë kombëtare dhe rendit publik kërkojnë ndryshe.

Neni 49
E drejta për arsimim

1. Refugjati në Republikën e Shqipërisë gëzon të drejtën e arsimimit në institucionet publike njëlloj si shtetasi shqiptar.

2. Institucionet arsimore publike para-universitare janë të detyruara të regjistrojnë refugjatin, me paraqitjen nga vetë kërkuesi të dokumenteve përkatëse, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

3. Ministri përgjegjës për çështjet e arsimit përcakton kriteret e vlerësimit të nivelit të arsimimit të refugjatit. Vlerësimi bëhet nga njësia arsimore vendore, që mbulon institucionin në të cilin kërkon të regjistrohet refugjati.

4. Refugjati ka të drejtë të konkurrojë për arsimin e lartë, sipas kritereve të përcaktuara në fuqi për arsimin e lartë.

5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të mbulojë shpenzimet, që rrjedhin nga legjislacioni për arsimin e lartë, për ciklin e parë të studimeve të larta për refugjatin. Mbulimi i shpenzimeve përfshin vetëm periudhën kohore, të parashikuar për marrjen e diplomës përkatëse.

6. Shuma e shpenzimeve dhe kriteret për dhënien e kësaj mbështetjeje përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50
Mësimi i gjuhës shqipe

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në bashkëpunim me institucionet përkatëse arsimore, organizon kurse të gjuhës shqipe, të edukimit qytetar dhe kurse kualifikimi për refugjatët.

2. Kriteret dhe procedura e bashkëpunimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.

Neni 51
E drejta për punë

Refugjati ka të drejtën për t'u pajisur me leje pune për raste të veçanta që nga momenti i marrjes së statusit, si dhe gëzon të njëjtat mundësi ligjore në tregun e punës sikurse shtetasi shqiptar.

Neni 52
Pajisja me leje pune

1. Autoriteti përgjegjës për çështjet e migracionit në ministrinë që mbulon çështjet e punës pajis me leje pune refugjatin, me kërkesën e këtij të fundit, të dërguar nëpërmjet autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

2. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen, ripërtëritjen apo anulimin e lejes së punës së refugjatit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 53
Karakteristikat e lejes së punës dhe regjistrimi në zyrën e punësimit

1. Leja e posaçme e punës ka, përveç të tjerave, këto karakteristika:
a) jepet për një periudhë 1-vjeçare dhe ripërtërihet në përfundim të këtij afati, me kërkesën e personit të interesuar;
b) është e vlefshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
c) kërkohet dhe është e vlefshme edhe në rastin e vetëpunësimit.
2. Leja e punës për refugjatin jepet pa pagesë.
3. Refugjati regjistrohet në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ushtron veprimtarinë ekonomike.

Neni 54
E drejta për trajtim social

1. Refugjati gëzon të drejtën e trajtimit social njëlloj si shtetasi shqiptar, në përputhje me legjislacionin përkatës nga institucionet përkatëse.
2. Në kuptim të këtij ligji, me trajtim social kuptohen:
a) sigurimet shoqërore;
b) ndihma ekonomike;
c) sigurimet shëndetësore.

Neni 55
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Refugjati i punësuar dhe i siguruar gëzon të drejtën për të përfituar nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 56
Ndihma ekonomike

1. Refugjati, pas marrjes të statusit, përfiton ndihmë ekonomike sipas legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
2. Kjo ndihmë jepet edhe për familjen e refugjatit, të cilit i mungojnë krejtësisht të ardhurat dhe mjetet e jetesës ose i ka ato të pamjaftueshme.
3. Refugjati, për sa kohë trajtohet në qendrën e pritjes për azilkërkuesit ose në ato të strehimit të përkohshëm, nuk përfiton ndihmë ekonomike.

Ministri i Brendshëm dhe ministri që mbulon çështjet sociale me udhëzim të përbashkët parashikojnë rastet e përfitimit të ndihmës ekonomike, sipas nivelit të ardhurave dhe mjeteve të jetesës. Përjashtim bëhet vetëm në raste të veçanta, të përcaktuara me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës dhe ministrit që mbulon çështjet sociale, kur niveli i të ardhurave dhe mjetet e jetesës janë tepër minimale.

Neni 57
Shpërndarja e ndihmës ekonomike

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët përcjell dokumentacionin e nevojshëm pranë autoriteteve kompetente për shpërndarjen e ndihmës ekonomike.
2. Ndihma ekonomike për refugjatët jepet nga njësia e qeverisjes vendore ku ka vendqëndrimin refugjati, në bazë të legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
3. Ndihma ekonomike, kriteret dhe procedura për dhënien e ndihmës ekonomike miratohen nga Komisioni Qendror pranë Shërbimit Social Shtetëror, me propozimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Neni 58
Përfitimi i ndihmës dhe kujdesit shoqëror

1. Refugjati gëzon të drejtën e ndihmës dhe kujdesit shoqëror, njëlloj si shtetasi shqiptar. Dokumentacioni përkatës përgatitet për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
2. Kriteret, procedura për përfitimin e ndihmës dhe kujdesit shoqëror dhe lista e dokumentacionit përkatës përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e punës dhe sociale.

Neni 59
Vendosja në institucionet e përkujdesjes shoqërore

1. Refugjati, që përmbush kriteret e legjislacionit në fushën e përkujdesjes shoqërore, mund të vendoset në institucionet publike të përkujdesjes. Dokumentacioni i pranimit në këto institucione miratohet nga Komisioni Qendror pranë Shërbimit Social Shtetëror, me propozimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në bazë të të dhënave të mbajtura në regjistrat e posaçëm.

2. Ministri përgjegjës mund të lidhë kontrata me institucione jopublike të përkujdesjes shoqërore për trajtimin e refugjatëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 60
E drejta për strehim

Refugjati në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë të gëzojë mundësitë ligjore për përfitimin e strehimit, si shtetasi shqiptar.

Neni 61
Strehimi i refugjatit në qendrën e pritjes për azilkërkuesit

Përjashtimisht, refugjati, në mungesë të mundësive të veta për strehim, ka të drejtë të qëndrojë në qendrën e pritjes për azilkërkuesit ose në ato të strehimit të përkohshëm.

Neni 62
Ndihma për strehim nëpërmjet pagesës së pjesshme të qirasë

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të mbulojë deri në 50 për qind të shumës së qirasë për strehimin për një periudhë 6-mujore, kur refugjati është në pamundësi për t'u strehuar me mjete të vetat.

2. Me kërkesë të refugjatit, periudha e përfitimit mund të shtyhet edhe për gjashtë muaj të tjerë, kur vazhdojnë kushtet e parashikuara më lart.

3. Kriteret për dhënien e kësaj ndihme, masa e përfitimit dhe kërkesat e tjera procedurale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII
BASHKIMI FAMILJAR I REFUGJATIT

Neni 63
Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për bashkim familjar

1. Kërkesa për bashkim familjar paraqitet pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët nga ana e refugjatit dhe personave në mbrojtje.

2. Refugjati paraqet aplikimin për bashkim familjar pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, duke plotësuar formularin e veçantë të aplikimit. Nëse është e nevojshme, i garantohet përkthyes për plotësimin e aplikimit.

3. Në rastin e paraqitjes së aplikimit për bashkim familjar, aplikuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të sigurojë strehim në kushte normale jetese, sipas standardeve për shëndetin dhe sigurinë;

b) të garantojë sigurimin shëndetësor për vete dhe familjen e tij;

c) të garantojë burime të qëndrueshme të ardhurash financiare për të siguruar veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së sigurimeve shoqërore apo pa qenë në ngarkim të Buxhetit të Shtetit.

4. Formulari i aplikimit duhet të shoqërohet me një kopje të noterizuar të dokumenteve të udhëtimit të anëtarëve të familjes dhe me prova të dokumentuara të lidhjes familjare të aplikuesit me personin ose personat me të cilin/të cilët kërkohet bashkimi familjar. Në formular përfshihen të dhënat biografike të personit me të cilin kërkohet bashkimi familjar dhe të dhëna për lidhjen familjare me aplikuesin. Nëse është e mundur, në mënyrë që të marrë dëshmi se ekziston një marrëdhënie familjare, organi përgjegjës mund të zhvillojë intervista apo hetime të tjera që janë të nevojshme.

5. Nëse refugjati nuk mund të paraqesë prova të dokumentuara zyrtarisht të marrëdhënies familjare, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr në konsideratë prova të tjera apo indicie, të cilat vlerësohen në pajtim me legjislacionin e brendshëm, lidhur me ekzistencën e kësaj marrëdhënieje. Vendimi për refuzimin e kërkesës nuk mund të bazohet vetëm në faktin e mungesës së provave të dokumentuara.

6. Shqyrtimi i aplikimit për bashkim familjar fillon brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të aplikimit.

7. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në përfundim të procedurës, shprehet me vendim të arsyetuar.

8. Formulari i aplikimit dhe formati tip i vendimit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës.

9. Vendimi për aplikimin për bashkim familjar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merret brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit.

10. Në rastin kur aplikimi për bashkimin familjar ka lidhje me një të mitur të pashoqëruar, vendimi merret brenda 20 ditëve nga dita e paraqitjes së aplikimit.

11. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim aplikuesin për vendimin, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tij.

12. Gjatë shqyrtimit të aplikimit, organi vendimmarrës duhet të këtë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Neni 64

E drejta e bashkimit familjar të refugjatit dhe procedura e aplikimit

1. Anëtarët e familjes së refugjatit dhe ata nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar. Këtë të drejtë mund ta gëzojnë përjashtimisht edhe personat që janë nën mbrojtje të përkohshme.

2. Refugjati i mitur dhe i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me prindërit, motrat, vëllezërit, anëtarë të tjerë të familjes, të cilët bashkëjetojnë me të ligjërisht ose që janë të mitur dhe të pamartuar. Kur këta persona të familjes, të shkallës së parë, në linjë të drejtë, nuk mund të gjenden, i mituri i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me kujdestarin ligjor ose me ndonjë të afërm tjetër, jo në linjë të drejtë.

3. Në rast të një martese poligame, kur një nga bashkëshortët e refugjatit jeton me të në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të autorizohet hyrja, qëndrimi dhe dhënia e bashkimit familjar të bashkëshortit ose bashkëshortes tjetër dhe as të fëmijëve të këtij bashkëshorti ose bashkëshorteje, pa paragjykuar dispozitat e konventës "Mbi të drejtat e fëmijës" të vitit 1989.

4. Në rast të një martese poligame, kur bashkëshortët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, aplikuesi ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me njërin nga bashkëshortët dhe me fëmijët e këtij bashkëshorti ose bashkëshorteje, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

5. Refugjati ka të drejtë të aplikojë për bashkim familjar, vetëm pas dhënies së vendimit përfundimtar.

6. Gjatë shqyrtimit të aplikimit lidhur me bashkimin familjar të partnerit/partneres, bashkëjetues/e të aplikuesit, do të merren si provë e marrëdhënies familjare faktorë, si fëmijë i përbashkët, banim i përbashkët, regjistrim i partneritetit dhe çdo mjet tjetër prove i besueshëm.

7. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të kryejë intervista me aplikuesin dhe anëtarët e tij të familjes, si dhe regjistron të gjitha të dhënat e përfituara gjatë shqyrtimit të aplikimit.

8. Gjatë procedurës së aplikimit për bashkim familjar aplikuesi mund të ndihmohet, të këshillohet ose të përfaqësohet nga një avokat.

Neni 65

Sanksionet dhe e drejta e ankimit

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të refuzojë aplikimin për bashkim familjar, të revokojë ose të refuzojë rinovimin e lejes së qëndrimit të familjes nëse vërtetohet një nga rastet:

a) për arsye të cenimit të sigurisë publike, sigurisë kombëtare dhe shëndetit publik;

b) kur nuk përmbushen kushtet e përcaktuara nga ky ligj;

c) kur aplikuesi për bashkim familjar ose anëtarët e familjes së tij në vendin pritës, gjatë qëndrimit në vendin e origjinës, nuk kanë jetuar në marrëdhënie martesore ose familjare;

ç) kur vërtetohet se janë paraqitur të dhëna të pavërteta, dokumente të falsifikuara apo janë përdorur mashtrime;

d) kur provohet se martesa ose birësimi janë bërë me qëllimin e vetëm për t'i mundësuar personit të interesuar hyrjen dhe qëndrimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Vendimi i refuzimit të aplikimit, revokimit për bashkim familjar apo refuzimit për të rinovuar lejen e qëndrimit të familjes duhet të jetë i arsyetuar.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin mund të realizojë inspektime për vërtetimin e rasteve të parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij neni.

4. Kundër vendimit të refuzimit të aplikimit, revokimit apo mosrinovimit të lejes mund të bëhet ankim pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit me shkrim të vendimit.

5. Kundër vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mos-marrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 66
Të drejtat e anëtarëve të familjes së refugjatit për bashkim familjar

Anëtarët e familjes së refugjatit, që kanë përfituar nga vendimi për bashkim familjar, kanë të njëjtat të drejta sikurse dhe aplikuesi për:

a) arsimim në institucionet arsimore publike;

b) punësim dhe vetëpunësim;

c) këshillim profesional dhe trajnim.

Neni 67
Hyrja dhe qëndrimi i anëtarëve të familjes

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për çështjet e punëve të jashtme për vendimin për pranimin e kërkesës për bashkim familjar.

2. Personat, që përfitojnë nga vendimi për bashkimin familjar, pajisen me vizë hyrjeje në kufi, në rast se kërkohet një e tillë. Ata pajisen me leje qëndrimi, sipas rregullave dhe procedurave që zbatohen për dhënien e lejeve të qëndrimit për refugjatin.

KREU VIII
MBROJTJA E PËRKOHSHME

Neni 68
Mbrojtja e përkohshme

1. Mbrojtja e përkohshme u jepet të huajve, të cilët masivisht hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vendi në të cilin, për shkak të një lufte apo të një situate të përgjithshme të dhunës, të shkeljes të të drejtave të njeriut, kur shteti, nga i cili kanë ardhur, nuk mund të garantojë mbrojtjen e tyre.

2. Mbrojtja e përkohshme jepet kur:

a) personi ka vendqëndrimin e tij të përkohshëm/të përhershëm në shtetin nga i cili vjen dhe, për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ka ardhur në Republikën e Shqipërisë;

b) personi, i cili qëndron në Republikën e Shqipërisë edhe pse i ka përfunduar afati i qëndrimit, nuk mund të kthehet në shtetin ku ka pasur vendqëndrimin apo vendbanimin për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

3. I huaji, i cili gëzon mbrojtje të përkohshme, mund të paraqesë në çdo kohë aplikim për azil.

4. Nëse është paraqitur aplikim për azil gjatë periudhës së mbrojtjes së përkohshme, shqyrtimi i këtij aplikimi duhet të fillojë vetëm pas përfundimit të afatit të mbrojtjes së përkohshme.

Neni 69
Kompetenca për dhënien dhe afati i mbrojtjes së përkohshme

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët jep mbrojtje të përkohshme për një periudhë 1-vjeçare.

2. Mbrojtja e përkohshme, nëse ekzistojnë arsye, mund të zgjatet automatikisht për një periudhë prej 6 muajsh, por jo më shumë se 3 vjet.

3. Për procedurën e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e përkohshme zbatohet, për aq sa është e mundur, procedura për shqyrtimin e aplikimit për azil, përveçse kur rrethanat e fluksit masiv diktojnë ndryshe.

Neni 70
Refuzimi i mbrojtjes së përkohshme

Mbrojtja e përkohshme nuk i jepet të huajit nëse:

a) nuk ekzistojnë rastet e situatave të parashikuara në nenin 68 të këtij ligji;

b) ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenet 5 dhe 19 të këtij ligji;

c) ka kryer një krim në Republikën e Shqipërisë, për të cilin parashikohet një dënim me burg mbi 5 vjet, i cili nuk është parashkruar;

ç) ka statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese;

d) ka shtetësinë shqiptare ose leje qëndrimi, sipas ligjit për të huajt.

Neni 71
Përfundimi i mbrojtjes së përkohshme

1. Mbrojtja e përkohshme përfundon:

a) me mbarimin e afatit të caktuar;

b) kur arsyet për mbrojtje të përkohshme nuk ekzistojnë më;

c) kur i huaji largohet nga Republika e Shqipërisë;

ç) nëse të huajit i është dhënë një lloj tjetër mbrojtjeje, sipas një ligji të caktuar ose një marrëveshjeje ndërkombëtare;

d) nëse i huaji gëzon mbrojtje ndërkombëtare ose qëndron në mënyrë të rregullt në Republikën e Shqipërisë;

dh) nëse i huaji i nënshtrohet masës së dëbimit.

2. Në rast të përfundimit të mbrojtjes së përkohshme, sipas pikës 1, të këtij neni, me përjashtim të shkronjës "c", të huajit në mbrojtje të përkohshme i njihet e drejta e kthimit vullnetar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shkronja "dh", e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet për personat të cilët, për shkak të gjendjes shëndetësore të rënduar ose për arsye humanitare, nuk mund t'i nënshtrohen masës së dëbimit, për sa kohë zgjat kjo situatë.

4. Gjatë ekzekutimit të masës së dëbimit, autoritetet përgjegjëse duhet të respektojnë të drejtat, liritë dhe dinjitetin e të huajit, të cilit i ka përfunduar mbrojtja e përkohshme.

Neni 72
Të drejtat dhe detyrimet e të huajve nën mbrojtje të përkohshme

1. I huaji, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme, ka të drejtën:

a) e banimit;

b) që t'i garantohen kushtet themelore të jetesës e të strehimit;

c) e kujdesit shëndetësor;

ç) e arsimimit fillor dhe të mesëm;

d) e këshillimit ligjor;

dh) e lirisë së fesë;

e) për punë.

2. Detyrimet e përcaktuara në nenin 18, të këtij ligji, zbatohen edhe për të huajt, të cilëve u është dhënë mbrojtje e përkohshme.

Neni 73
E drejta për bashkim familjar

1. Përjashtimisht, përveç të drejtave të parashikuara në nenin 72, të këtij ligji, një i huaj nën mbrojtje të përkohshme gëzon të drejtën për të kërkuar bashkim familjar, nëse kjo e drejtë nuk mund të realizohet në asnjë vend tjetër, përveçse vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për paraqitjen e aplikimit zbatohet, për aq sa është e mundur, neni 64 i këtij ligji.

2. E drejta për bashkim familjar i njihet edhe të miturit që nuk e ka krijuar akoma familjen e tij dhe bashkëshortit të të huajit, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme.

3. Mbrojtja e përkohshme zgjatet edhe për anëtarët e tjerë të familjes.

Neni 74
Strehimi i të huajve nën mbrojtje të përkohshme

Të huajit, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme, i sigurohet strehim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 75
Leja e qëndrimit dhe vërtetimi për të huajin nën mbrojtje të përkohshme

Të huajit nën mbrojtje të përkohshme i lëshohet vërtetim dhe leje qëndrimi e përkohshme, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara për azilkërkuesit, për aq sa përshtaten.

Neni 76
Dispozitë referuese

Dispozitat referuar refugjatëve do të zbatohen për aq sa përshtaten edhe ndaj të huajve nën mbrojtje të përkohshme.

Neni 77
Kufizimi i të drejtave

I huaji, që aplikon për azil përgjatë mbrojtjes së përkohshme, nuk mund të përdorë të drejtat e azilkërkuesit, për aq kohë sa zgjat mbrojtja e përkohshme.

KREU IX
MBROJTJA PLOTËSUESE

Neni 78
Cenimi serioz

Me cenim serioz, për qëllim të dhënies së statusit të mbrojtjes plotësuese, kuptohet:

a) dënimi me vdekje apo ekzekutimi; ose

b) tortura apo trajtimi ose dënimi johuman apo degradues, si dhe zhdukja me forcë e aplikuesit në vendin e origjinës; apo

c) kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës së një personi, për shkak të dhunës, pa dallim në situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm.

Neni 79
Pushimi i statusit të mbrojtjes plotësuese

1. I huaji apo personi pa shtetësi nuk gëzon më statusin e mbrojtjes plotësuese kur rrethanat, për të cilat është dhënë ky status, nuk ekzistojnë më ose kanë ndryshuar në një masë të tillë saqë mbrojtja nuk është më e nevojshme.

2. Pika 1 nuk zbatohet ndaj personit me statusin e mbrojtjes plotësuese, i cili dëshmon se nuk mund të gëzojë mbrojtjen nga shteti i tij apo shteti në të cilin ka vendbanimin e zakonshëm për personat pa shtetësi, pasi ekzistojnë akoma arsye të imponuara nga cenimi i mëparshëm.

Neni 80
Përjashtimi

I huaji apo personi pa shtetësi përjashtohet nga dhënia e statusit të mbrojtjes plotësuese kur ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:

a) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte apo krim kundër njerëzimit, të përcaktuara sipas instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare;

b) ka kryer një krim të rëndë;

c) është fajtor për vepra që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, sipas përcaktimit të neneve 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

ç) cenon rendin dhe sigurinë publike të Republikës së Shqipërisë.

Neni 81
Dhënia e statusit të mbrojtjes plotësuese

1. Statusi i mbrojtjes plotësuese i jepet të huajit ose personit pa shtetësi, kur ekzistojnë rrethanat e përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji.

2. Procedura, afatet për dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese dhe e drejta e ankimit realizohen sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj për dhënien e statusit të refugjatit, për aq sa mund të zbatohen.

Neni 82
Revokimi, përfundimi apo refuzimi për të ripërtërirë statusin e mbrojtjes plotësuese

1. Statusi i mbrojtjes plotësuese revokohet, përfundon apo nuk i ripërtërihet të huajit apo personit pa shtetësi, kur:

a) paraqiten rrethanat e nenit 80 të këtij ligji;

b) paraqitja e fakteve të pavërteta ose fshehja e tyre, si dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara kanë qenë vendimtare për dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët shqyrton individualisht faktet dhe rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 83
Të drejtat dhe detyrimet e të huajve nën mbrojtje plotësuese

1. I huaji, të cilit i është dhënë statusi i mbrojtjes plotësuese, ka të drejtën:

a) t'i garantohen kushtet themelore të jetesës, të banimit e të strehimit;

b) e kujdesit shëndetësor dhe social;

c) e arsimimit fillor dhe të mesëm;

ç) e këshillimit ligjor;

d) e lirisë së fesë;

dh) e bashkimit familjar;

e) e pajisjes me leje qëndrimi;

ë) e punësimit.

2. Detyrimet e përcaktuara në nenin 18, të këtij ligji, zbatohen edhe për të huajt të cilëve u është dhënë statusi i mbrojtjes plotësuese.

Neni 84
Dokumenti i udhëtimit dhe letërnjoftimi elektronik për të huajt në mbrojtje plotësuese

1. Të huajit në mbrojtje plotësuese, me kërkesën e tij, i lëshohet letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi, që i mundëson atij të udhëtojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur cenohet siguria kombëtare apo rendi publik.

2. Kriteret dhe procedura për pajisjen me letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi për këtë kategori personash përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

3. Formati i dokumenteve të sipërpërmendura përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 85
Dispozita kalimtare

Lejet e punës së refugjatëve dhe përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në përfundim të datës së përfundimit të tyre sa kohë që nuk anulohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nuk bëhen të pavlefshme, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 86
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 2, 22, pika 2, 32, pika 2, 52, pika 2, 62, pika 3, dhe 84, pika 3.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për azilin dhe refugjatët që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e

këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pikat 2 dhe 3, 20, pika 3, 26, pika 3, 27, pika 5, 29, pikat 1 dhe 2, 38, pika 5, 43, pika 3, 63, pika 7, dhe 84, pika 2.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e arsimit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 49, pikat 3 dhe 6, dhe nenit 50, pika 2.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e punës dhe mirëqenies sociale dhe ministri përgjegjës për azilin dhe refugjatët që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 56, pika 3, dhe nenit 58, pika 2.

Neni 87

Shfuqizime

Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligji nr. 9098, datë 3.7.2003, "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë", si edhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 88

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2014

Shpallur me dekretin nr. 8736, datë 8.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 74/2014

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gledis Gjipali zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.10.2014

VENDIM
Nr. 75/2014

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pirro Misha zgjidhet anëtart i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.10.2014

DEKRET
Nr. 8731, datë 6.10.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fatbardha Sali Aliu
2. Fidan Musli Aliti
3. Nderim Mensur Nexhipi (Nedjipi)
4. Resmije Azem Maloku
5. Dardan Feim Karimani
6. Arb Smajl Manaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8732, datë 7.10.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Robin B. Sun Li Sun
2. Yongqiang Yongzhe Zhao
3. Yingshan Qinshen Zheng
4. Qiming Peihao Chen
5. Xiaoxiong Pengnian Zhang

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr. 6, datë 6.10.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012 "DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE"

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 92 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1. Në nenin 3, pika 1 dhe 2, germa "b", togfjalëshi "ose agjencia e shitjes, e ngarkuar prej tij" shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Edmond Haxhinasto

UDHËZIM
Nr. 7, datë 7.10.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 11.2.2010 "MBI KONTROLLIN TEKNIK TË MJETEVE RRUGORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1. Në nenin 1, pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Drejtuesit e mjeteve rrugore që kanë tahograf të instaluar në mjet, duhet të paraqesin te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor (KTV) certifikatën e kryerjes së operacionit teknik (inspektim/kalibrim) të tahografit, të lëshuar nga ofiçina e autorizuar. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet.".

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

KËRKESË
Nr. 4111/3, datë 7.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan, loti III, rrëshqitjet".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit "arë".

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 3 575 303 (tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e tre) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
SEKTORI I SHPRONESIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA , TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve pasuritë e të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tirane-Elbasan Loti III" (Rreshqitjet)

Nr.	Pronari			Z.K	Nr.pas.	Lloji Pasurise	Sip.totale (m2)	Sip.shp. (m2)	Çmimi (l/m2)	Vlera (leke)	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri								
1	I paidentifikuar			3346	360/1	Are		383	167	63961	I pakonfirmuar
2	I paidentifikuar			3346	318/7	Are		329	167	54943	I pakonfirmuar
3	I paidentifikuar			3346	447/3	Are		257	167	42919	I pakonfirmuar
4	I paidentifikuar			3346	494/2	Are		4255	167	710585	I pakonfirmuar
5	I paidentifikuar			3346	494/3	Are		3375	167	563625	I pakonfirmuar
6	I paidentifikuar			3346	494/1	Are		2332	167	389444	I pakonfirmuar
7	I paidentifikuar			3346	494	Are		100	167	16700	I pakonfirmuar
8	I paidentifikuar			3674	79/21	Are		637	167	106379	I pakonfirmuar
9	I paidentifikuar			3674	79/49	Are		308	167	51436	I pakonfirmuar
10	I paidentifikuar			3674	79/22	Are		177	167	29559	I pakonfirmuar
11	I paidentifikuar			3674	79/17	Are		105	167	17535	I pakonfirmuar
12	I paidentifikuar			3674	79/20	Are		1151	167	192217	I pakonfirmuar
13	I paidentifikuar			3674	79/24	Are		347	167	57949	I pakonfirmuar
14	I paidentifikuar			3674	79/46	Are		622	167	103874	I pakonfirmuar
15	I paidentifikuar			3674	79/19	Are		692	167	115564	I pakonfirmuar

16	I paidentifikuar			3674	79/18	Are		171	167	28557	I pakonfirmuar
17	I paidentifikuar			3674	79/45	Are		122	167	20374	I pakonfirmuar
18	Nazmi	Qerim	Allhasa	3419	105/4	Are	2550	1259	167	210253	konfirmuar ZVRPP
19	Bashkepronesi (Hajrije Nezir Allhasa etj.)			3419	105/1	Are	2550	2068	167	345356	konfirmuar ZVRPP
20	Qerim	Kasem	Allhasa	3419	105/3	Are	1098	172	167	28724	konfirmuar ZVRPP
21	Qerim	Kalem	Allhasa	3419	106/6/1	Are	1000	73	167	12191	konfirmuar ZVRPP
22	Qerim	Kasem	Allhasa	3419	106/3	Are	580	580	167	96860	konfirmuar ZVRPP
23	Sulejman	Sali	Allhasa	3419	106/4	Are	300	197	167	32899	konfirmuar ZVRPP
24	Jonuz	Shaqir	Sula	3419	106/1	Are	1397	686	167	114562	konfirmuar ZVRPP
25	Bashkepronesi (Qazim Riza Sula etj.)			3419	106/2/1	Are	1200	1011	167	168837	konfirmuar ZVRPP
	Shuma							**21409**		**3575303**	

KËRKESË
Nr. 4244/3, datë 7.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga objekti "Rehabilitimi i stacionit të pompimit Trush".

Subjekti kërkues i këtij objekti është SHA Ujësjellës Fshat Shkodër. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit "arë".

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë SHA Ujësjellës Fshat, Shkodër, (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 13 333 868 (trembëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
SEKTORI I SHPRONESIMEVE
SH. A. UJESJELLES FSHAT SHKODER

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA "REHABILITIMI I STACIONIT TE POMPIMIT TRUSH - SHKODER"

N/R	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Lloji Pasurise	Sip. Totale (m2)	Vleresimet			Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri					Sip. shpronsim (m2)	Cmimi (lek/m2)	Vlera (leke)	
1	**BASHKEPRONARET "RROJI"**			1648	103	ARE	55970	17252	262	**4520024**	Konfirmuar ZVRPP
2	**SHTET**			3205	1298/45	ARE	2860	406	333	**135198**	Konfirmuar ZVRPP
3	**NAZIF**	HALIT	**PERVIZI**	3205	1298/3	ARE	2120	900	333	**299700**	Konfirmuar ZVRPP
4	**SHTET**			3205	1298/4	ARE	2120	1500	333	**499500**	Konfirmuar ZVRPP
5	**HAJRULLAH**		**PELLUMBI**	3205	1298/35	ARE	2000	2000	333	**666000**	Konfirmuar ZVRPP
6	**HAJRULLAH**		**PELLUMBI**	3205	1298/36	ARE	388	194	333	**64602**	Konfirmuar ZVRPP
7	**FERID**	SYLO	**PELLUMBI**	3205	1298/6	ARE	3180	3180	333	**1058940**	Konfirmuar ZVRPP
8	**XHEMAL**	DAN	**MUÇEJANI**	3205	1298/7	ARE	2120	1940	333	**646020**	Konfirmuar ZVRPP
9	**MUSA**	OSMAN	**MUÇEJANI**	3205	1298/37	ARE	2000	1864	333	**620712**	Konfirmuar ZVRPP
10	**MUSA**	OSMAN	**MUÇEJANI**	3205	1298/38	ARE	976	821	333	**273393**	Konfirmuar ZVRPP
11	**HYSNI**	OSMAN	**MUÇEJANI**	3205	1298/10	ARE	3000	3000	333	**999000**	Konfirmuar ZVRPP
12	**ZENEL**	BRAHIM	**MUÇEJANI**	3205	1298/9	ARE	2000	2000	333	**666000**	Konfirmuar ZVRPP
13	**HAMDI**	OSMAN	**MUÇEJANI**	3205	1298/11	ARE	2500	2008	333	**668664**	Konfirmuar ZVRPP
14	**ENVER**	KASEM	**BUSHATI**	3205	1298/12	ARE	3710	2783	333	**926739**	Konfirmuar ZVRPP
15	**ENVER**	TEOFIK	**VERRI**	3205	1298/39	ARE	3600	2365	333	**787545**	Konfirmuar ZVRPP
16	**DYLAVER**	TEOFIK	**VERRI**	3205	1298/41	ARE	4000	1329	333	**442557**	Konfirmuar ZVRPP
17	**SHTET**			3205	1298/15	ARE	2120	178	333	**59274**	Konfirmuar ZVRPP
	SHUMA							43720		**13333868**	

KËRKESË
Nr. 4451, datë 1.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Ndërhyrje të përkohshme rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza"".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Vlera totale e shpronësimit është 9 203 086 (nëntë milionë e dyqind e tre mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh.

Lista

1. Zona kadastrale 8280 me nr. pasurie 2/335, në pronësi të Ornela Mansaku.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro

SHPRONËSIM I PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN "NËNË TEREZA""

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi lekë/m²		Vlera lekë			Shënime
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Ndërtesë	Banesë	
1.	Ornela Mansaku	8280	2/335	135.0	135.0	23,955.0	44,216.007	3,233,925	5,969,161		Kartela e pasurisë
				135	**135.0**			**3,233,925**	**5,969,161**	**-**	**9,203,086**
	TOTALI						**lekë**				

VENDIM
Nr. 17, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE NDËRMARRJA UJËSJELLËS KANALIZIME, BASHKIA PUKË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence, për efekt të përfundimit të afatit operatorit Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime, Bashkia Pukë, me:

Drejtues ligjor: Demir Hyseni;

Drejtues teknik: Lindita Hyseni.

2. Operatori Ndërmarrja UJ Bashkia Pukë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Pukë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më datë 13.7.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 18, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit kategorisë D, të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë operatorit sh.a. Ujësjellës Kanalizime Durrës, me:

Drejtues ligjor: Spartak Kovaçi;

Drejtues teknik: Adrian Zhamo;

Drejtues teknik: Artor Koçilja.

2. Operatori sh.a UK Durrës autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura;

Kategoria D: Për trajtimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkitë Durrës, Shijak, Vorë, Sukth, Manëz;

Komunat: Prezë, Maminas, Gjepalaj, Katund i ri, Fushë-Kuqe, Bupq Ishëm, Thumanë, Xhafzotaj, Rrashbull.

4. Kjo licencë është e vlefshme për kategoritë A dhe C deri më datë 21.4.2017, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 19, datë 22.4.2013. Afati i vlefshmërisë për kategorinë D, është 1, vit deri më datë 13.7.2015.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 19, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE "ELBER" SHPK

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik operatorit "Elber" sh.p.k., me:

Drejtues ligjor: Altin Cenolli;

Drejtues teknik: Julian Doci.

2. Operatori "Elber" sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Elbasan.

4. Kjo licencë është e vlefshme deri më datë 19.1.2015 siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 6, datë 19.1.2011.

KRYETARI
Avni Dervishi

KËRKESË

Shtetasi Gazment Mëhalla, i biri i Dervishit dhe i Sabiresë, i datëlindjes 19.5.19992, lindur dhe banues në Mollas, Elbasan, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Agron Mëhalla.

KËRKUESI
Gazment Mëhalla

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja "Kristalina"
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 32 lekë